Kronikë

EMRI/ Atentat me armë zjarri në Rrilë të Lezhës, plagoset 54-vjeçari! U zu në pritë sapo la fëmijët në shkollë

Agron Puka, 54-vjeç ka mbetur i plagosur nga të shtënat me armë zjarri në drejtim të tij teksa po udhëtonte me makinë. Ngjarja ka ndodhur në fshatin Rrilë të Lezhës, pranë një shkolle, ku 54-vjeçari sapo kishte lënë fëmijët dhe është zënë në pritë nga autorët

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gerilluna

Redaksia
6 Mars, 08:13 | **Përditësimi: 6 Mars, 09:11**

Share

LEZHË- Agron Puka, 54-vjeç ka mbetur i plagosur pasi është qëlluar me armë zjarri në drejtim të tij teksa po udhëtonte me makinë.

Ngjarja ka ndodhur mëngjesin e sotëm (6 mars), në fshatin Rrilë të Lezhës, pranë një shkolle, ku 54-vjeçari sapo kishte lënë fëmijët.

Ai është zënë në pritë nga autorët të cilët kanë qenë me një Audi të bardhë, dhe kanë hapur zjarr në drejtim të tij kur viktima po udhëtonte me makinën tip 'Audi'.

LEXO EDHE:
Ura 'e vdekjes' në Shkopet i mori jetën Nënë Daves! Ishte ndërtuar nga banorët se shteti i braktisi

Report Tv sjell pamjet nga vendi i ngjarjes, dhe nga makina e cila është qëlluar me breshëri plumbash, ndërsa një plumb kapi Agron Pukën. Ky i fundit nuk raportohet të ketë precedent të mëparshëm penal, ndërsa mësohet se ka një fermë blegtorale në Balldren të Lezhës.

Agron Puka ndodhet në spital e sipas policisë është jashtë rrezikut për jetën.

> *'Rreth orës 08:00, në fshatin Rrilë, shtetasi A. P., 54 vjeç, banues në fshatin Rrilë, duke lëvizur me automjet, është plagosur me armë zjarri nga 1 person ende i paidentifikuar. 54-vjeçari është transportuar në spitalin rajonal të Lezhës, ku është në kujdesin e mjekëve (aktualisht jashtë rrezikut për jetën).*
>
> *Shërbimet e Policisë, me marrjen e njoftimin, kanë shkuar menjëherë ne vendngjarje, është rrethuar zona dhe janë ngritur pika kontrolli.*
>
> *Njëkohësisht, në ndihmë të Policisë vendore, janë nisur Forcat Kombëtare të Sigurisë të Njësisë Shkodër. Grupi hetimor, në drejtimin e Prokurorisë, vijon punën për sqarimin e rrethanave të ngjarjes dhe për identifikimin dhe kapjen e autorit.'- njofton policia.*

Lajmi në përditësim...

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 08:49

U qëllua teksa ishte në makinë, pamjet nga vendi i ngjarjes ku ndodhi atentati në Lezhë

Agron Puka ka mbetur i plagosur rëndë si pasojë e të shtënave me armë zjarri në drejtim të rij mëngjesin e sotëm në fshatin Rrilë të Lezhës. Burime për Report Tv bëjnë me dije se 54-vjeçarit i kanë zënë pritë dhe është qëlluar teksa po lëvizte me makinë.

Report Tv sjell pamjet nga vendi i ngjarjes, ku duket makina tip Audi, e cila është qëlluar me breshëri plumbash.

M.Q./Shqiptarja.com

Share

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: agron puka | Lezhe

Komento

Ndalohet reptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Gjykata dënon me 2 vite burg Belerin për blerje votash, si e vlerësoni?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Lezhë/ Qëndra Kulturore kthehet në kinema me filma për fëmijë

Elvis Hila

4 Mars, 15:38

E rëndë në Lezhë/ Po kalonte urën pa parmakë, 86 vjeçarja humb ekuilibrin dhe bie në lumë! Ishte ndërtuar nga banorët provizorisht

4 Mars, 15:27

Rama takim me strukturat në Lezhë: Të bëjmë vetëkritikë meqë s'jemi të sfiduar! PS përgjegjësi historike, progresin ta bëjë të pakthyeshëm

3 Mars, 19:04

VIDEO/ Aksident i frikshëm në Lezhë, përplasen 4 makina pranë një karburanti, dy të lënduar! Shkulet edhe një pemë

3 Mars, 17:14

Bie numri i lindjeve në Lezhë, mjekja: Gratë afgane lindin më shumë fëmijë se shqiptaret

Elvis Hila

3 Mars, 15:41

Basha 'thumbon' Ramën e Berishën: Po sulmojnë SPAK-un! Përsëriti kushtin për amnistinë! Spiropali: Prokuroria i ka duart e lira të bëjë punën

3 Mars, 13:07

'Bashkë, më të fortë'! Begaj i fton në Shqipëri për 'Besëlidhjen', rrëfehen arbëreshët: Nderojmë figurën e Skënderbeut, statuja e heroit në çdo 'shtëpi' tonën!

2 Mars, 20:29

Kurbin/ Gërryenin lumin Mat, arrestohen 2 punëtorët, në kërkim administratori! Bllokohen mjetet e rënda të kompanisë

2 Mars, 15:43

580-vjetori i Besëlidhjes së Lezhës, në kremtime merr pjesë presidenti Begaj dhe një delegacion arbëresh

Elvis Hila

2 Mars, 13:02

Tjetërsim pronash, GJKKO dënon me 1 vit e 4 muaj burg ish-kryebashkiaku i Lezhës Fran Frroka! Konfiskohen mbi 66 mijë m2 tokë

1 Mars, 15:29

VIDEO/ U fut në parakalim të gabuar në aksin Lezhë-Milot, gjobitet më 10 mijë lekë shoferi

1 Mars, 09:59

Aksidenti me dy viktima në Rrugën e Kombit në 2022, Apeli shpall të pafajshëm shoferin e makinës Marsel Busho, e liron nga qelia

29 Shkurt, 16:13

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet ripërdhimi i pasautorizuar i kesaj faqeje